



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

#### **EKSTRAKT**

**nga procesverbali i mbajtur më 01 gusht 2017, në mbledhjen e XXXVIII (tridhjetetë) të Komitetit për Komunitete.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.05’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Shaban Osmani, Bahri Selimi, Radisav Perović, Xhafer Ademi, Valmire Lahu dhe Mefail Rama, ndërsa munguan Xhevdet Beselica dhe Sabri Hamiti.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim, Bashkim Bajrami, Policia Kufitare, dhe përfaqësuesi i KFOR - LMT.

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesi i Komitetit, z. Shaban Ahmeti**, përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoj më gjerësisht rreth rendit të ditës, ndër të tjera shtoi, rendin e ditës dhe materialin përkatës e keni marrë me kohë, andaj nëse ndokush ka diçka rreth kësaj mbledhje, fjala është për ju, nëse jo e hedhë në votim.

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

#### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 5 korrik 2017**

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

**3. Identifikimi i nxënësve të komuniteteve pakicë të cilët eventualisht e kanë ndërprerë shkollimin në nivelin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë si dhe ndërmarrja e veprimeve për përfshirjen e tyre në procesin mësimor për vitin vijues shkollor.**

**Kryesuesi i Komitetit, z. Shaban Ahmeti**, theksoi, jam në dijeni se disa nxënës të komunitetit pakicë nuk kanë mund ta kalojnë testin për tu regjistruar në shkollë të mesme, por të njëjtit janë të interesuar të vazhdojnë shkollimin e mesëm.

**z. Xhafer Ademi**, theksoi, sa i përket identifikimit të nxënësve për regjistrim në shkolla të mesme ju informoj se në këtë vit gjithsejtë e kanë mbaruar klasën e nëntë 17 nxënës, ku prej tyre janë regjistruar 9 nxënës në shkolla të mesme, 4 prej tyre nuk dëshirojnë të regjistrohen me të cilët kemi disa probleme rreth kësaj çështje, ndërsa 4 nxënës kanë mbetur pa u regjistruar për arsye sepse në ato shkolla ku ata po dëshirojnë të regjistrohen nuk kanë mundur, kurse tani është afati i dytë për regjistrim dhe në biseda me drejtorin e shkollës përkatëse kemi premtime se do të pranohen – regjistrohen edhe ata 4 nxënës. Sa i përket nxënësve të shkollave fillore ju njoftoj se të gjithë ata nxënës të cilët e kanë filluar shkollimin të gjithë edhe e kanë përfunduar atë, do të thotë se nuk kemi pasur ngecje në këtë aspekt, kurse në vitin që vie ne do të shikojmë se a do ta vazhdojnë shkollimin apo jo, andaj në këtë aspekt mendoj se neve na duhet angazhim më i madh në mënyrë që ata nxënës të mos mbesin pa vijuar shkollimin e mesëm. Problem tjetër që nxënësit e komunitetit RAE të shkollave të mesme paksa e kanë shkollën larg dhe po i përtojnë rrugëtimit, fjala është për shkollën teknike, kurse në shkollën ekonomike numri i nxënësve të cilët pranohen është më i limituar dhe kryesisht regjistrohen nxënës me sukses më të mirë, mirëpo siç e ceka më parë kemi premtime nga drejtori i asaj shkolle se do t'i kenë parasysh regjistrimin e atyre nxënësve që dëshirojnë të regjistrohen në shollën e mesme ekonomike. Jemi duke u angazhuar që ata 4 nxënës të cilën nuk dëshirojnë të regjistrohen, t'i bindim se duhet të vijojnë shkollimin, prej tyre janë 3 prindër të cilët nuk dëshirojnë t'i dërgojnë fëmijët e tyre të vazhdojnë me shkollim, por ne do të kemi edhe një takim me ata prindër dhe do të shohim se çka mund të ndikojmë që ata nxënës të vazhdojnë shkollimin. Gjithashtu ju njoftoj se jemi në negociata me një Organizatë Gjermane e cila dëshiron të hap një klasë shtesë për nxënësit e komunitetit RAE por pa i kufizuar edhe nxënësit tjerë të komunitetit shumicë, organizatë e cila sa jam në dijeni ka të lidhur një memorandum edhe me Komunën për këtë aspekt, nuk e di a do të realizohet apo jo, mirëpo është e mirëseardhur.

**z. Mefail Rama**, theksoi, mendoj se për t'i identifikuar nxënësit e komunitetit RAE të cilët kanë ndërprerë shkollimin, ne duhet të bëjmë një listë të cilën pastaj ta dërgojmë në Drejtorin e Arsimit, e them këtë sepse sa i përket Komunitetit rom kemi disa nxënës të cilët janë kthyer nga diaspora të cilët dëshirojnë të vazhdojnë shkollimin por paraprakisht duhet të dërgojmë listën e tyre, pastaj Drejtoria e Arsimit të njëjtit t'i sistemoj nëpër shkolla dhe klasa të ndryshme ku kanë qenë. Konsideroj se në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit do të tejkalohej këto vështirësi që kemi duke përfshirë edhe ato çështje që u cekën nga parafolësi.

**z. Liman Zeqiri**, shef i Zyrës Komunal për Komunitete dhe Kthim, dëgjova me vëmendje parafolësit. Është normale se shkollimi është pika më ndjeshme që ne shumë herë kemi debatuar dhe është çështje e cila për ne është shqetësuese.

Jemi në dijeni se numri i nxënësve të Komunitetit RAE të cilët vijojnë shkollimin e mesëm të ulët nga 1 – 9 është numër i madh rreth 120-130, mirëpo pastaj numri i atyre që vijojnë shkollimin e mesëm të lart është paksa në rënie, çështje për të cilën ne është mirë të bëjmë studime për shkaqet dhe arsyet. Konsideroj se është mirë t'i bindim edhe ata 4 nxënës të cilët nuk dëshirojnë të vijojnë atë shkollim, sigurisht se ka shumë faktorë por fillimisht do të ishte mirë të bisedohet me prindërit e tyre, pastaj Drejtoria e Arsimit dhe drejtorët e shkollave përkatëse me mundësit e tyre që kanë të krijojnë hapësira për regjistrim dhe vijim të shkollimit normal për nxënësit e komunitetit RAE, gjë e cila nuk ka munguar asnjëherë.

Ne jemi në dijeni se është paksa vështirë për tu regjistruar në Gjimnaz dhe në Ekonomik sepse janë kriteret e caktuar si rezultatet, poentimi, testi etj, mirëpo edhe përkundër këtyre sërish po ndodh që po bëhen zgjidhje, kështu që mendoj se pas bisedave që do të kemi edhe me drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, nga i cili çdo herë kemi pas përkrahje në këtë drejtim dhe besoj se do të kemi, edhe ata 4 nxënës të cilën kanë mbetur pa u regjistruar në ekonomik, besoj se do të bëhet zgjidhje dhe të njëjtit do të regjistrohen. Sa i përket atyre nxënësve të kthyer nga diaspora, është problem i cili ka të bëjë edhe me nxënësit e komunitetit shumicë sepse ata të cilët kanë ndërprerë shkollimin dhe kanë shkuar në shtetet e jashtme sigurisht se kanë lënë vitin në gjysmë, pastaj ka që nuk janë notuar etj, sigurisht se është problem në vete sepse duhet të bëhet nostrifikimi i atyre diplomave ose certifikatave atje ku kanë vijuar shkollimin jashtë shtetit ku kanë qëndruar, procedurë kjo e cila shkon përmes MASHT-it në mënyrë që ata nxënës të mund ta vazhdojnë shkollimin.

Është mirë që në fillim të vitit shkollor më 1 apo 4 shtator të merremi më shumë me këto probleme në mënyrë që të jemi në dijeni me gjendjen reale të gjithë nxënësve të komunitetit RAE të gjitha niveleve dhe të marrim masa që të paktën për nivelin e ulët nga klasa 1 deri 9 që është obligative, ne në mënyrë kolegjiale duke përfshirë të gjithë akterët të ndikojmë edhe tek prindërit e atyre nxënësve të cilët eventualisht nuk i regjistrojnë ose nuk i lejojnë të fillojnë apo vazhdojnë shkollimin obligativ, përkatësisht të njoftohemi për shkaqet dhe arsyet e mos regjistrimit ose ndërprerjes së shkollimit të fëmijëve të tyre, dhe të shikohet mundësia e sanksionimit të atyre prindërve, ndërsa sa i përket shkollimit të mesëm të lartë, jemi në dijeni se nuk është obligative dhe sigurisht që prindërit nuk mund të sanksionohen por ne prej dëshirës së madhe që kemi për shkollim të të gjithë nxënësve pa dallime dhe arritjeve të suksesit sa më të madh në shkollim mendoj se duhet të investojmë dhe t'ju ndihmojmë në atë drejtim sepse investimet në arsim janë të domosdoshme në mënyrë që pastaj integrimi i njerëzve në shoqëri dhe arritja e sukseseve të jetë sa më i madh, kështu që në këtë aspekt unë kam qenë dhe do jem i gatshëm t'i ndihmoj dhe stimuloj në mënyra të ndryshme me bursa, donacione me Organizata të ndryshme etj në mënyrë që në vazhdimësi të rritet niveli dhe cilësia në arsim për nxënësit e Komuniteteve pakicë në veçanti.

Sa i përket Organizatës Gjermane që u cek nga z.Xhafer Ademi, është e vërtetë se Drejtoria e Arsimit ka një memorandum me të cilin shprehet mirëseardhja e të gjitha Shoqatave dhe donacioneve të cilat qojnë në progres apo që ndihmojnë arsimin në Komunën e Podujevës, kryesisht për nxënësit e komunitetit RAE, mirëpo duhet të përmendet se faktor tjetër i mos dërgimit të fëmijëve në shkolla mund të jetë edhe situata ekonomike e familjeve temë kjo e cila është e ndjeshme

mirëpo në të ardhmen duhen hulumtime dhe përkushtim që të paktën shkollimi mos të ndërprehet për këto arsye dhe të gjithë fëmijët të kenë hapësirë dhe mundësi të shkollohen dhe integrohen në shoqëri.

#### **4. Shqyrtimi i realizimit të Planit të punës të Komitetit për Komunitete për periudhën janar - qershor 2017**

**Kryesuesi i Komitetit, z. Shaban Ahmeti**, theksoi, mund të them se anëtarët e këtij komiteti gjithherë kanë qenë të angazhuar në përmbushjen e planit të punës dhe mendoj se edhe në vazhdim do të punojmë në realizimin e këtij plani, në mënyrë që të përmbushen objektivat e parapara në plan për vitin 2017, edhe përkundër asaj që jemi afër zgjedhjeve lokale dhe nuk e di saktësisht edhe sa mbledhje do t'i mbajmë. Deri në këtë periudhë konsideroj se plani është realizuar kënaqshëm.

**z. Xhafer Ademi**, theksoi, sa i përket realizimit të planit të punës për këtë periudhë unë mendoj se duke pasë parasysh mundësitë tona reale si Komitet për Komunitete janë trajtuar shumë tema dhe si plan është realizuar kënaqshëm.

#### **5. Të ndryshme**

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, kryesuesi i Komitetit e konstatoj mbledhjen të përfunduar.

**Mbledhja përfundoi në orën 11.25'.**

**Procesverbalin e mbajti  
Faik Gashi**

**Nr. 01-060/04-0067202/17  
Podujevë,  
01 gusht 2017**

**Kryesuesi i Komitetit  
Shaban Ahmeti**